

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-141/12

Prishtinë, 17 prill 2013

Në çështjen juridike të:

E. K.

H. K.

N. K.

Prishtinë/Pristina

Palët ankuese

Kundër

T. D.

Zelandë e Re

Paraqitësja e kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/121/2011, të datës 7 shtator 2011 (lidhur me lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA11399 dhe KPA11400), pas shqyrtimit të mbajtur më 17 prill 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa e E. K. kundër vendimit të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës KKPK /D/A/121/2011, të datës 7 shtator 2011 (për sa i përket lëndëve të regjistruara në AKP me numrat KPA11399 dhe KPA11400).
- 2- Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa e E. K., e paraqitur në emër të H. K. dhe N. K. kundër vendimit të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës KKPK /D/A/121/2011, të datës 7 shtator 2011 (për sa i përket lëndëve të regjistruara në AKP me numrat KPA11399 dhe KPA11400),.
- 3- Obligohet pala ankuese duhet t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 4 korrik 2006, T. D. (më tutje “paraqitësja e kërkesës”), si bartëse e së drejtës pronësore paraqiti një kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) për vërtetimin e të drejtës pronësore të saj mbi ngastrën nr. 1814/2 me sipërfaqe prej 21 ari dhe 30 metra katrorë; ngastrën nr.1818/2 me sipërfaqe prej 20 ari dhe 37 metra katrorë, dhe ngastra nr. 1819/2 me sipërfaqe prej 71 ari e 83 metra katrorë (ajo po ashtu kërkoi ri-posedimin).

Për ta mbështetur kërkesën e saj ajo paraqiti shumë dokumente.¹ Më vonë gjatë procedurës, ajo paraqiti prova² shtesë.

¹ Letërnjoftimin e paraqitëses së kërkesës të datës 20 qershor 2006; Fletën Poseduese nr. 6633, të lëshuar më 16 qershor 2006 nga Zyra Kadastrale e Prishtinës, Republika e Serbisë (që tregon se paraqitësja e kërkesës dhe vëllai i saj – S. K.) janë pronarë të pronave të kërkuara), secilit ½ të pjesës ideale; Kopja e Planit nr. 953-2/2006-230, të lëshuar më 16 qershor 2006 nga Zyra Kadastrale e Prishtinës, Kruševac, Republika e Serbisë; Vendimin e trashëgimisë nr. 147/84, të lëshuar më 2 tetor 1984 nga Gjykata Komunale e Prishtinës, me të cilin paraqitësja e kërkesës dhe vëllai i saj janë shpallur trashëgimtar për ngastrat me numrat: 4940/2; 1814/2 (prona

AKP-ja ka njoftuar palët potencialisht të interesuara më 21 mars 2008 lidhur me ngastrën 1814/2 dhe më 24 shtator 2010 lidhur me ngastrat 1818/2 dhe 1819/2.

Më 21 mars 2008, N. K. paraqiti një përgjigje lidhur me ngastrën 1814/2 dhe më 1 tetor 2010 lidhur me ngastrat 1818/2 dhe 1819/2. Ai pretendoi të drejta ligjore mbi të gjitha këto ngastra.

As E. e as H.K. nuk kanë shprehur interesim që të marrin pjesë në procedurën para AKP-së.

Për ta mbështetur pozicionin e tij pala përgjegjëse në kërkesë N. K. paraqiti një numër dokumentesh³.

e kërkuar); 1818/2 (prona e kërkuar) dhe 1819 (prona e kërkuar), me sipërfaqe të përgjithshme prej 1 ha, 15 ari 61 m²; Vendimin mbi Vlerësimin e Tatimit në Pronë për personat fizik nr. 432-1/2265, të lëshuar më 25 mars 1995 nga Administrata Shtetërore e Tatimore – Departamenti për Vlerësimin dhe Mbledhjen e Tatimeve Prishtinë;

² Kopjet e Planit të datës 15 shtator 1967 dhe 19 janar; Fletën Poseduese nr. 2290, të lëshuar më 2 gusht 1982, nga Zyra Kadastrale e Komunës së Prishtinës, që tregon emrin e L. Đ.; Vendimin e Gjykatës Komonale të Prishtinës nr. 170/82, të datës 1 shtator 1982, me të cilin pas vdekjes së L. Đ. (gjyshja e paraqitëses së kërkesës) V. D. (daja i e paraqitëses së kërkesës) dhe J. K. (nëna e e paraqitëses së kërkesës) janë shpallur trashëgimtarë të ½ për secilin të shtëpisë dhe tokës – ngastrat me numrat: 1814, 1818, 4940 dhe 1819, me sipërfaqe totale prej 2.31.14 ha; Vendimin e Gjykatës Komonale nr. 636/82, të datës 21 dhjetor 1982, që tregon se prona e trashëguar e paluajtshme me bashkëpronarë – ngastrat me numrat 4940, 1814, 1818 dhe 1819, të regjistruara në Fletën Poseduese nr. 2290, Komuna Kadastrale PRISTINA, janë të ndara (në dy pjesë – ½ për secilin) ndërmjet V. D. (daja i e paraqitëses së kërkesës) – i cili (pas ndarjes) mori pronësinë e një shtëpie me dy anekse, një oborri dhe toke tjetër (të regjistruar më pas me numra të ri – ngastrat kadastrale me numrat: 4940/1, 1814/1, 1818/1 dhe 1819/1, me sipërfaqe totale prej 1.15.51 ha), dhe J. K. (nëna e e paraqitëses së kërkesës) – e cila (pas ndarjes) mori pronësinë e një shtëpie me dy anekse, një oborri dhe toke tjetër (të regjistruar më pas me numra të ri – ngastrat kadastrale me numrat: 4940/2, 1814/2, 1818/2 dhe 1819/2 me sipërfaqe totale prej 1.51.51 ha); Kopjen e Planit (lidhur me ngastrën nr. 4940/2) të datës 10 qershor 1985, që tregon emrin e paraqitëses së kërkesës dhe të vëllait të saj; Kopjen e Planit (pa numër), të lëshuar më 11 janar 1987 (lidhur me ngastrat: 1814/2; 1818/2, 1819/2 dhe 4940/2), që tregon emrin e paraqitëses së kërkesës dhe të vëllait të saj si shfrytëzues; Autorizimin e vëllait të paraqitëses së kërkesës (S. K.), me të cilin autorizon O. D. të lidh kontratë të shitjes në emër të tij për ngastrat: 4940; 1814; 1818 dhe 1819; Kopjen e Planit lidhur me ngastrën nr. 1814/2 (pa numër), të lëshuar më 12 gusht 1994, nga Zyra Kadastrale e Prishtinës, Komuna e Prishtinës, Republika e Serbisë, që mban emrin e paraqitëses së kërkesës dhe të vëllait të saj; Kontratën e Vërtetuar të Dhurimit nr. 6011/94, të datës 19 gusht 1994, të lidhur ndërmjet S. K. (vëllai i paraqitëses së kërkesës), si dhurues dhe T. K. D. (paraqitëse e kërkesës) si pranuese. Me këtë kontratë dhuruesi jep si dhuratë pjesët e tij të barabarta ½ të ngastrës kadastrale nr. 1814/2 motrës së tij – pranuses; Kopjen e Planit nr. 953-2-2006-230 (lidhur me ngastrat: nr. 1814/2; nr. 1818/2 dhe nr. 1819/2), të lëshuar më 16 qershor 2006 nga Zyra Kadastrale e Prishtinës, Kruševac, Republika e Serbisë, që mban emrin e paraqitëses së kërkesës dhe të vëllait të saj si bashkë-shfrytëzues; Padia e paraqitëses së kërkesës e dorëzuar para Gjykatës Komonale në Prishtinë, të datës 25 tetor 2007, me të cilin kërkohet anulimin e Kontratës së vërtetuar të Blerjes nr. 3030/2000, të datës 27 tetor 2007; Autorizimin e vërtetuar nr. 2508 të datës 18 shtator 2008, me të cilin O. D. ka autorizuar N. A. nga Shkupi, Maqedoni, që ta shfrytëzojë ngastrën e pronës së kërkuar nr. 4940 dhe ngastrat me numrat: 1814/1 dhe 1814/2, 1818/1, 1818/2, 1819/1 dhe 1819/2, si dhe të lidh kontratë të blerjes me palët e treta për t'i shitur ato; Aktgjykimin nr. 2355/07 të Gjykatës Komonale të Prishtinës, të datës 15 dhjetor 2010, me të cilin kërkesa (padia) e T. D. (paraqitëse e kërkesës) aprovohet dhe nënshkruhet transaksioni (kontrata e vërtetuar e blerjes nr. 3030/2000) nga N.A. në emër të O. D. dhe S. K., si shitës në njërin anë dhe vëllezërit Ksi blerës në anën tjetër, e shpallur i pavlefshëm, në pjesën në të cilën S. K. ka shitur këtë patundshmëri të ½ të pjesëve ideale të ngastrave kadastrale me numrat: 4940/2, me sipërfaqe totale 0.02.13 ha, Zona Kadastrale e Prishtinës, nr. 1814/2 me sipërfaqe 0.21.30 ha, 1818/2 me sipërfaqe prej 0.20.37 ha, dhe 1819/2 me sipërfaqe prej 0.71.83 ha, të gjitha në Veternik, Zona Kadastrale e Prishtinës;

³ Letërnjoftimin e tij, të datës 16 korrik 2004; Autorizim e vërtetuar nr. 1821/2000, të datës 14 korrik 2000, me të cilin O.D.(bashkëshortja e dajës së paraqitëses së kërkesës) ka autorizuar N. A. të posedojë, shfrytëzojë dhe lidh e nënshkruajë kontratë të blerjes lidhur me ngastrën e kërkuar nr. 4940 ; Faturën (pa datë dhe numër – data e pranimit në AKP është 4 prill 2007, që tregon se O.D. ka pranuar çmimin e blerjes lidhur me pronën e kërkuar; Deklaratën (pa datë dhe numër – data e pranimit në AKP është 4 prill 2007), që shpreh vullnetin e O.D. që ta shes pronën e kërkuar; Kontratën e Blerjes (pa datë dhe numër – data e pranimit në AKP është 4 prill 2007) lidhur me pronën e kërkuar, të lidhur ndërmjet O. D si shitëse dhe H., E. dhe N. (pala përgjegjëse në kërkesë) K si blerës; Certifikatën e vdekjes të dajës së paraqitëses së kërkesës nr. 203, të datës 15 qershor 1995; Certifikatën e martesës nr. 28, të datës 21 qershor 1995, të V.D. (daja i paraqitëses së kërkesës) dhe O.(J.) D. Vendimi mbi Trashëgimi i Gjykatës Komonale të Prishtinës nr. 197/95, të datës 14 shtator 1995, me të cilin është vendosur që pronar i pronave të mbetura (pas vdekjes së V.D më 3 qershor 1995) është O. (J.) D.; Plani Kadastral i datës 14 janar 2005; dhe Tapia nr. 1929, e datës 4 shkurt 1929.

Paraqitësja e kërkesës pranoi një letër informimi nga AKP së bashku me një kopje të përgjigjes së palës përgjegjëse në kërkesë dhe dokumentet e dorëzuara.

Bazuar në dokumentet e paraqitura, të dhënat në dispozicion dhe masat procedurale të ndërmarra sipas nenit 11.3 (c) dhe (d) të UNMIK/REG/2006/50 e ndryshuar me ligjin nr. 03/L-079, KKPK vërtetoi se paraqitësja e kërkesës është pronare e 1/2 të pronave të kërkuara – ngastrat 1814/2, 1818/2 dhe 1819/2 dhe se ajo ka të drejtë posedimi të pronave të cekura. Në këtë drejtim, është miratuar një vendim në dobi të saj – vendimi grupor KKPK/D/A/121/2011, i datës 7 shtator 2011 (paragrafët 36-38 posaçërisht kanë të bëjnë me ngastrat e kontestuara), dhe vendimet për identifikimin e pronave të datës 1 nëntor 2011.

Vendimi iu dërgua palës përgjegjëse në kërkesë më 15 dhjetor 2011.

Më 22 tetor 2012 E. K. (më tutje: pala ankuese) paraqiti një ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Ankesa nuk përmend ndonjë ankesë të veçantë. Është një formular i zbarzët, i nënshkruar nga E. K., që përmban fjalinë “Unë i kam dorëzuar të gjitha dokumentet që i kisha”.

Ankesa është e nënshkruar vetëm nga E.K., por teksti i dokumentit thekson se ankesa është paraqitur nga E., N. dhe H. K..

E. K.nuk ka autorizim për ta përfaqësuar H.K. dhe N.K..

Drejtori Ekzekutiv i AKP-së informoi paraqitësen e kërkesës rreth ankesës kundër vendimit të KKPK-së.

Arsyetim ligjor:

Lidhur me ankesën e paraqitur në emër të N. K. dhe H.K.:

Ankesa mund të paraqitet ose nga personi që ka të drejtë të ankohet apo nga përfaqësuesi i tij/saj – neni 85.1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore (më tej: LPK), i cili shprehimisht rregullon mundësinë e përfaqësimit të autorizuar në të gjitha nivelet e procedurës civile (vendi sistematik i nenit 85 është në kreun V të LPK-së, që është në Pjesën e Dytë të Ligjit – Dispozitat e Përgjithshme që përcaktojnë zbatueshmërinë e saj gjatë tërë procesit të procedurës para një Gjykate, përderisa nuk parashihet ndryshe). Për qartësi të argumenteve mund të ceket se LPK-është e zbatueshme në procedurat e Gjykatës Supreme *mutatis mutandis* – neni 12.2 i UNMIK/REG/2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79).

Përfaqësimi i autorizuar mund t'i jepet çdo personi që ka zotësi të plotë për të vepruar – neni 86.1 LPK dhe çdo veprim i kryer në procedurë nga përfaqësuesi i palës brenda kufijve të autorizimit ka efekt të njëjtë juridik sikur t'i ketë kryer vet pala – neni 86.2 *ibid*.

Autorizimi për përfaqësim mund të jepet me shkrim apo gojarisht në procesverbal – neni 92.1 *ibid* – forma me shkrim është vet-shpjeguese, autorizimi në procesverbal bëhet para Gjykatës përkatëse. Duke marrë parasysh se nuk ka nevojë të caktohet një shqyrtim kryesor në procedurën e tanishme të apelit, autorizimi ka mundur të bëhet vetëm me shkrim. Megjithatë, nuk ka prova se H. dhe N.K. e kanë autorizuar vëllain e tyre z. E. K. që të paraqes ankesë kundër vendimit të KKPK-së para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme. Z. N. K., i cili ka qenë palë përgjegjëse në kërkesë në shkallën e parë, është informuar rreth vendimit në fjalë dhe nëse do të kishte dashur të ankohet ndaj vendimit ai ka mundur ta bënte këtë vet apo ta autorizonte vëllain e tij në mënyrë të përshtatshme ligjore – duke nënshkruar një autorizim. Z. H.K. po ashtu nuk e ka nënshkruar autorizimin për Z. E.K. dhe ky i fundit nuk është i autorizuar të paraqesë ankesë në emër të tij.

Si rrjedhojë, ankesa në emër të N. dhe H. K. e paraqitur nga një person i cili nuk është autorizuar ta bëjë këtë është e palejueshme dhe duhet të hidhet poshtë.

Përveç kësaj, vendimi i është dërguar z. N. K. më 15 dhjetor 2011 dhe edhe nëse ai do ta kishte autorizuar E. K. që të paraqes një ankesë në emër të tij (të cilën nuk e ka bërë), ankesa edhe pse do të ishte e lejueshme në bazë të përfaqësimit të saktë ligjor, megjithatë do të ishte e vonuar meqë është paraqitur vetëm më 22 tetor 2012 – shumë më vonë se periudha 30-ditëshe brenda së cilës ka mundur të paraqitet – argumenti në nenin 12.1 të UNMIK/REG/2006/50 e ndryshuar me ligjin nr. 03/L-079.

Pasi që ankesa është e palejueshme, Gjykata Supreme nuk duhet të vendos rreth çështjeve ligjore lidhur me të drejtat materiale të palëve, sipas neneve 186 dhe 196 të LPK-së.

Lidhur me ankesën e E. K. në cilësinë personale:

Kjo ankesë është gjithashtu e palejueshme sepse pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën e shkallës së parë.

Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 parasheh që: *"Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të*

paraqesë [..] ankesë ndaj vendimit të tillë”. Përveç kësaj, neni 176.1 i Ligjit 03/L-006 të Procedurës Kontestimore parasheh se e drejta për të paraqitur ankesë i përket palëve në procedurën e shkallës së parë.

Pala në kërkesë dhe procedurën përkatëse është *“Çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë [...], me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive në pajtim me nenin 10.1.”* (Neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Z. E. K. nuk ka marrë pjesë në procedurën e shkallës së parë para KKPK-së.

Sipas nenit 10.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079: *“Personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdo qoftë gjatë procedurës.”* Megjithatë, në këtë rast të veçantë nuk ka arsye për të besuar se Z. E. K. ka qenë i painformuar për procedurën para KKPK-së dhe si rrjedhojë i penguar që të merr pjesë në të me qëllim që të përfitoj nga dispozita e cekur më lartë. Palët e interesuara janë njoftuar në mënyrë të rregullt dhe njëri nga vëllezërit K. – Z. N. K. ka paraqitur përgjigje, nuk ka pasur pengesë që edhe Z. E. K. të paraqes përgjigje.

Si rrjedhojë, pala ankuese E. K. nuk mund të pranohet si palë në procedurën e shkallës së dytë para Kolegjit të Apelit të AKP-së. Ankesa duhet të hidhet poshtë si e palejueshme (neni 13.3 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079; shih edhe nenin 195.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore).

Pasi që ankesa është e palejueshme, Gjykata Supreme nuk duhet të vendos rreth çështjeve ligjore lidhur me të drejtat materiale të palëve.

Shpenzimet e procedurës

Në bazë të Shtojcës III, neni 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore është i vlefshëm për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës: 30 €. Kjo shumë është vendosur në përputhje me nenin 10.11 të UA 2008/2 (lidhur me tarifat që paguhen për paraqitje të ankesës).

- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit: € 30. Kjo shumë është llogaritur sipas neneve 10.21 (sa i përket tarifave që duhet të paguhen për marrjen e një vendimi në procedurë të apelit), 10.15 (sa i përket tarifave që duhet të paguhen për rastet kur një padi hidhet poshtë) dhe 10.1 (që përshkruan rregullin e përgjithshëm të llogaritjes së tarifës) të UA 2008/2.

Këto tarifa duhet të paguhen nga pala ankuese që humb rastin brenda 15 ditësh nga data e dorëzimit të këtij aktgjykimi palës ankuese.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike..

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it